

Sabit SYLA & Safet HASANI

**KRIMET E FORCAVE SERBE NË KOMUNËN E VUSHTRISË
(1998-1999)**

Krimet e forcave serbe në Kosovë ishin të përmasave aq të mëdha sa që kanë të bëjnë me gjenocidin ideor, teorik dhe praktik, i organizuar me vrasjen e njerëzve në baza etnike, nacionale, racore, religjioze apo politike, si dhe veprime tjera të qëllimshme që çojnë në eliminimin fizik të ndonjë populli. Krimet përfshinin dëbimin e popullatës, masakrat, pastrimin etnik të njohur me emrin e koduar “plani patkoi”, dhunimet, plaçkitjet, helmimin e puseve, fshehjen e kufomave, fshirjen e identitetit, keqpërdorimin e civilëve, shkatërrimin e vendbanimeve dhe minimin e terrenit. Kësisoj, ato ishin aksion i paramenduar dhe i planifikuar nga Serbia, përkatësisht nga qarqet e saj politike, shkencore, kulturore dhe ushtarake. Ky lloj gjenocidi e krimi ishte në kundërshtim të plotë me të drejtën ndërkombëtare. Viktima kanë qenë civilë, fëmijë, pleq, gra, persona të sëmurë edhe të pambrojtur. Vrasjet kanë qenë një nga format më të rënda të realizimit të projektit serb, ku gjatë vitit 1999 u bënë fenomen masiv dhe i përditshëm që rrezikonte shqiptarët pa dallim.¹

Në pranverën e vitit 1998, por edhe më herët, në tërë qytetet e Kosovës ishin krijuar grupe të armatosura ekstremiste serbe, të ashtuquajtura “Mbrotje Territoriale”, “Shtabe të Krizave” etj., që u formuan kryesisht nëpër qytete dhe vendbanime me shumicë serbe. Ato vunë nën kontroll çdo lëvizje nëpër qytete. Kështu, jeta nëpër qytete nga këto njësi u bë tejet e vështirë. U vendos një shtet policor. Çdo qytetar serb ishte i armatosur dhe kryente detyrën e policit, që realizonte çdo akt të dhunës pa kurrfarë droje. Përshkallëzimi i situatës sa vinte e shtoej, ashtu si në pjesët tjera të Kosovës edhe në Vushtrri. Në këtë të fundit, Njësia e quajtur “Shtabi i Krizave”, u formua më 13 qershor 1998. Ishin 11 anëtarë kryesorë të këtij shtabi. Secili zyrtar kishte detyrat e veta për të vepruar sipas planifikimit, operacioneve dhe udhëzimeve të dhëna nga Qeveria e Serbisë, gjegjësisht nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) e organe tjera gjegjëse. Ky

¹ Sabit Sylla, *Shala e Bajgorës në luftën çlirimtare, 1998-1999 (Batalioni IV)*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2019, f. 287-288.

Shtab ishte pjesëmarrës i akteve më mizore e përgjegjës për krimet e kryera në Vushtrri dhe rrethinë, krahas sektorëve tjerë të aparatit shtetëror serb. Shtabi në fjalë përbëhej nga: Sllobodan Dokniq, Dragan Spasiq, Dushan Steviq, Dragan Çeliq, Sllobodan Dançetoviq, Mirko Mrkiq, Vuçina Janiçeviq, Dragan Millovanoviq, Trajko Rakiq, Nebojsa Gjurkovqç dhe Filip Jezdiq.²

Me fillimin e bombardimeve të NATO-s mbi caqet ushtarake-policore serbe vjen deri te një përshkallëzim i situatës që u manifestua me riorganizimin e strukturave të forcave të armatosura serbe. Në kuadër të këtij riorganizimi, krahas organizimit të njerëzve dhe grupeve të armatosura serbe riorganizohet edhe “Shtabi i krizave regjionale”, me synimin për t’iu “përgjigjur sulmeve të NATO-s dhe të UÇK-së”, që në fakt, veprimet e të cilit do të dëshmoreshin si forcë persekutuese kundër popullatës civile shqiptare. Selia e këtij shtabi ishte në Mitrovicë, ndërsa zona e saj e përgjegjësisë mbulonte komunat: Mitrovicë, Vushtrri, Zubin Potok, Leposaviq dhe Skënderaj. Shtabi në fjalë u themelua më 24 mars 1999.

Të gjithë anëtarët e këtij shtabi morën detyra konkrete për t’iu kundërvënë popullatës shqiptare për dëbim nga vatrat e tyre, duke ushtruar dhunë dhe terror mbi civilë të paarmatosur. Disa u mobilizuan për t’u prirë edhe ushtrisë dhe policisë, siç ishte Vuçina Janiçeviq, ndërsa të tjerët grumbullonin mjete për t’i furnizuar mercenarët e ardhur nga Serbia dhe vendet tjera. Vepronin edhe në mënyra tjera të ndryshme për realizimin e planeve serbe kundër shqiptarëve. “Shtabi regjional i krizave”, në Mitrovicë drejtohej nga Zdravko B. Trajkoviq, kurse nën varësinë e tij ishin: Zoran Bratiq, Desimir Petkoviq, Dragan Jabllanoviq, Sllobodan Dokniq, Srgjan Vuloviq, Sima Simiq, Dragisha Radaq, Zllatko Galak, Suzana Zakiq, Branisllav Ivanoviq, Radashin Kasalloviq, dr. Radosllav Orllloviq, Hranisllav Llazareviqu, Radoje Kreqkoviq, Petar Bishevac, Vllastimir Rajkoviq, Lubisha Radoviq, Milladin Miniq, Dobrosav Dobriq, Rade Utviqu, Dushan Dançetoviq, Miodrag Jeroviq dhe Desanka Millosavleviq. Në qytetin e Vushtrrisë, krahas organeve tjera gjegjëse një rol të rëndësishëm kishte kontrolli dhe menaxhimi i “Shtabit të krizave”, veprimet e të cilit në terren u zbatuan nga komandanti regjional i policisë serbe, Vuçina Janiçeviq, zv/komandanti i Policisë në Vushtrri të mbështetur dhe ndihmuar nga Zoran Simiqi, komandanti i Policisë në Prelluzhë, Dejan Janiçeviq, pastaj Dragan Mihajllloviqu (Novosellë), Zoran Kostiq (Prelluzhë), Trajko

² Dok. Nr. 1/98. 13.06.1998 Vushtrri “Mbrojtja Territoriale, Grupi i Shtabit të Krizave në Komunën e Vushtrrisë”; Safet Hasani, *Qyteti tragjik: krimet serbe në qytetin e Vushtrrisë, 1998-1999*, Prishtinë: Biblioteka Ndërkomunale “Hivzi Sylejmani”, 2016, f. 42.

Rakiq (Prelluzhë), Sasha Millojeviq (Druar), Lubisha Simiq (Vërrnicë), komandanti Policisë në Vushtrri, Dragan Petroviq³ etj.

Vrasjet masive në komunën e Vushtrrisë ishin vazhdimësi e një varg krimesh apo vrasjesh në masë, që forcat e armatosura serbe kryen kundrejt popullatës civile shqiptare në rajonin e Vushtrrisë qysh nga viti 1998. Në mëngjesin e hershëm të datës 22 shtator 1998, trupat serbe të shoqëruar me artileri të rëndë, marshuan në drejtim të fshatit Oshlan. Marshimi u bë nga drejtimi i Mitrovicës, ku ishin angazhuar Togu 5 i Njërive Speciale Policore (NJSP) dhe një tog i saj nga Sekretariati i Punëve të Brendshme i Mitrovicës, të mbështetura nga grupi luftues BG-125-4, i Brigadës 125 të Ushtrisë së Jugosllavisë.⁴

Këtu zhvillohet edhe një nga betejat më të ashpra, ku UÇK-ja ishte pozicionuar në vijën e mbrojtjes në Gurbardh, në “Rrogën e Zhigës”, te “Zabeli i Marës”, te “Kodra e Vogël” në pjesën veriore të Ashlanit dhe te Kodra e Kishës. Luftimet zgjatën tërë ditën. Në mbrëmje, rreth orës 21:35, forcat e UÇK-së organizuan formën e luftës diversante në pozicionet e forcave serbe dhe teknikën e saj duke shkatërruar një tank, një autobлиндë dhe një kamion, si dhe duke vrarë dhe plagosur disa ushtarë dhe policë. Kjo betejë zgjati edhe në ditët në vijim më 23 dhe 24 shtator 1998.⁵ Meqë në këtë fshat, kishte mijëra shqiptarë civilë, ushtria serbe kishte hedhur granata të kalibrave të ndryshme, duke mos i zgjedhur fare pozicionet, nëse janë të UÇK-së, apo të popullatës civile. UÇK-ja në këtë betejë pati disa ushtarë të vrarë e të plagosur. Përveç ushtarëve të rënë pati edhe një numër të konsiderueshëm civilësh të vrarë*. Edhe pse ishte gjendje e rëndë lufte, ku në çdo cep operonte ushtria dhe policia serbe, ceremonia e varrimit u krye me himn kombëtar.⁶ Pas vendosjes së kontrollit mbi këtë fshat, forcat serbe dogjën rreth 78 shtëpi⁷ dhe pas tërheqjes së tyre në pyll u gjetën kufomat e një numër të konsiderueshëm civilësh të vrarë.⁸

³ Dok. Nr. 428-8-2 nga 25.03.1999. Urdhëresa për formimin e Mbrojtjes Territoriale DT. Nr. 80/1, 24.03.1999.

⁴ Sabit Syla, *Shala e Bajgorës në luftën çlirimtare...*, f. 174.

⁵ Miftar Kurti, *Vrojtime historike*, Prishtinë: “Faik Konica”, 1997, f. 70-71.

* Milazim Mani, Kada Zajmi Mani, Selatin Hyseni, Halit Hyseni, Lutfi Hyseni, Arsim Ibrahim, Hajrullah Gjaka, Idriz Mehmeti, Hysen Hajrizi, Rrahim Mehmeti, Asllan Sheremeti, Musa Sheremeti, Mirdi Sheremeti, Maliq Sheremeti, Fatime Zeqiri, Sheremet Sheremeti, Halil Ibrahim, Selim Segaqa dhe Bahtir Shyti.

⁶ Sabit Syla, *Arsimi shqip në Mitrovicë (Mësimdhënës dhe luftëtarë të lirisë)*, Prishtinë: “Libri Shkollor”, 2013, f. 188.

⁷ *FHP*, Dosije: 125 motorizovana Brigada Vojske Jugosllavije, Beograd, f. 8-9.

⁸ *Po aty*, f. 8.

Forcat serbe arritën që më datë 23 shtator 1998 të depërtonin edhe në fshatin Dubovc. Menjëherë filluan me djegien e shtëpive. Banorët e fshatit ikën në pyjet e malit Çyqavicë.⁹ Po të njëjtën ditë, 23 shtator 1998, forcat serbe filluan granatimin e pandërprerë të malit Çyqavicë. Nën zjarrin e artilerisë u gjendën edhe vendet ku strehoheshin mijëra civilë. Gjatë granatimit të Çyqavicës, periudha 23-26 shtator 1998, sipas burimeve të FDH-së, midis shumë të vrarëve kishte edhe fëmijë.¹⁰ Ndërkohë, më 24 shtator në një mal afër Dubovcit dhe Galicës, 15 civilë shqiptarë* ishin gjetur të vrarë, të cilët një ditë më parë ishin strehuar në malin në fjalë. Disa prej tyre ishin gjetur pranë një rruge malore, kurse të tjerë më thellë në pyll, që të gjithë të masakruar.¹¹ Sipas disa burimeve, kryesit e këtij akti makabër që morën pjesë në këtë masakër të shqiptarëve ishin: Zoran Simiqi, Zoran Petkoviqi, Aca Kompiroviqi, Ilija Elezoviqi, romi Ibrahim Qizmolli, romët Ali (Tupanxhia) me të birin dhe romi tjetër me emrin Hamush.¹² Kufomat e tyre, të gjitha, kanë qenë të masakruara, me pjesë të trupit të prerë, si këmbët, duart, sytë e nxjerrë, kokën e prerë, gjithashtu të prera kishin edhe organet gjenitale dhe pjesë tjera të trupit.¹³

Masakra e Studimes, 2 maj 1999

Në fillim të majit të vitit 1999 forcat e armatosura serbe filluan një ofensivë duke granatuar disa fshatra në rajonin përreth Bajgorës. Më 2 maj 1999, ato thyen linjën e UÇK-së në afërsi të Bajgorës e Melenicës, duke i detyruar të largohen civilët shqiptarë që ishin strehuar në këtë rajon. Kolona e refugjatëve lëvizi në drejtim të jugut nga fshatrat Ceceli dhe Sllakovc, ku atyre iu bashkuan edhe shqiptarë tjerë që kishin kërkuar strehim në këto anë. Kolona përbëhej prej qindrash automjetesh apo prej 3 000 deri 5 000 refugjatësh, që shtrihej deri në fshatin Studime e Epërme. Forcat serbe përcollën kolonën dhe gjatë rrugës dogjën shtëpitë në fshatrat Sllakovc e Ceceli.¹⁴

⁹ *Po aty*, f. 10-11.

¹⁰ *Po aty*, f.10.

* Bujar Halili, Bajram Sahiti, Bekim Halili, Hajredin Lahu, Hetem Halili, Agim Ademi, Nazmi Halili, Hasime Shabani, Nexhat Halili, Burim Ademi, Shashivar Ademi, Sejdi Kabashi, Fatmir Ademi, Enver Kastrati dhe Gani Ademi.

¹¹ *FHP*, Dosije: 125 motorizovana Brigada..., f. 10-11.

¹² Dëshmi e Fadil Beqirit, kryetar i KMDLNJ-së, dega në Vushtrri dhe Miftar Riza Halilit nga Galica. Dëshmia u është dhënë edhe organizatave ndërkombëtare si; OSCE, KFOR, UNMIK etj., por nuk është marr asnjë nga ata që kryen ato vepra kriminale.

¹³ *Shih: Buletini*, KMDLNJ, Nr. 9, f. 122.

¹⁴ *Po Naredenju - Ratni zločini na Kosovu*, Human Rights Watch, 2001, f. 491.

Kolona fillimisht kishte arritur në Ceceli për të vazhduar më pas në drejtim të Studimes së Epërme, Studimes së Poshtme dhe në qytetin e Vushtrrisë. Rruga nga Sllakovci deri në Studime të Epërme ishte e gjatë, rreth 7km. Midis Cecelisë dhe Studimes së Epërme kolona u gjend nën zjarrin e artilerisë së Ushtrisë Jugosllave (UJ), zjarrin nga pushkët që vinin nga drejtimi i Sllakovcit, lagjes “Rashica” në Studime të Poshtme, Svaraçak e Epërme dhe nga veriu. Rreth orës 15:00 zjarri nga artileria dhe pushkët bëri që kolona të ndalej në Studime të Epërme. Së paku dy veta u lënduan në kolonë nga të shtënat.¹⁵ Po të njëjtën ditë, rreth orës 16:00-17:00, kolona filloi të lëvizë përsëri. Por, gjatë lëvizjes u dëgjuan edhe të shtëna të përsëritura nga armët automatike. Rreth orës 18:00, kolona u ndal përreth rrugës në një vend të mbrojtur nga zjarri. Ky vend ndodhet 3km nga Studime e Poshtme. Forcat serbe në këtë rajon kishin vendosur orën policore, e cila fillonte nga ora 16:00. Pas errësimit, shtëpitë në Studime të Epërme po digjeshin, kurse nga drejtimi i fshatit vinin të shtëna nga armët automatike.¹⁶ Rreth orës 17:00, forcat serbe me automjete të blinduara arritën deri te pjesa veriore e kolonës. Pjesëtarët e forcave serbe bartnin uniforma të kamufluara ngjyrë të gjelbër, uniforma të kamufluara ngjyrë të kaltër dhe uniforma me ngjyrë të zezë. Disa bartnin edhe shami në kokë. Disa nga forcat serbe kishin fytyrat e ngjyrosura, e disa bartnin maska plastike që mbulonin gjithë fytyrën dhe fytin, me hapje në sy dhe gojë. Pjesëtarët e veshur me uniforma të kamufluara ngjyrë të gjelbër dhe kaltër që iu afruan kolonës, ishin pjesëtarë të MPB-së dhe UJ.¹⁷

Pjesëtarët e forcave serbe kishin kërkuar mjete financiare nga njerëzit në kolonë, duke i kërcënuar në forma të ndryshme. Një grup serbësh të armatosur, të cilët vozisnin xhip dhe mjete të blinduara, kishin arritur te pjesa kryesore e kolonës, e cila kishte mbetur në rrugë në drejtim të Studimes së Poshtme. Policia kishte ardhur nga drejtimi i lagjes “Rashica” në Studime të Epërme. Ata kishin dalë nga automjeti dhe nga njerëzit në kolonë përveç që kërkuan para, i gjuajtën me armë zjarri ata të cilët e kundërshtuan një gjë të tillë. Madje policia e kishte zbritur një burrë nga traktori dhe e kishte varur. Pjesëtarët e forcave serbe kishin deklaruar, se nuk do të ndaleshin deri sa t’i vrisnin 100 persona.¹⁸ Disa raste individuale të vrasjeve kishin ndodhur nga forcat serbe që kishin plaçkitur refugjatët në

¹⁵ *Međunarodni sud za krivično gonjenje lica odgovornih za teška kršenja međunarodnog humanitarnog prava počinjena na teritorije bivše Jugoslavije of 1991, godine (MSKG)*, predmet Đorđević Vlastimir, Ujedinjene Nacije, 2010, f. 441.

¹⁶ Po aty.

¹⁷ Po aty, f. 441-442.

¹⁸ *Po Naređenju - Ratni zločini na Kosovu...*, f. 496.

kolonë.¹⁹ Një dëshmitare që ishte në traktorin e parë të kolonës rrëfeu atë çfarë kishte parë më 2 maj 1999, rreth orës 20:00: “...me të arritur në Studime të Poshtme pamë ushtarët që ishin rreshtuar pranë anës së majtë të rrugës. Na thanë që të zbrisnim nga traktori dhe t’i mbanim duart në qafë. Ata filluan të na shanin, bërtisnin e të na rrihnin”.²⁰ Ndërkohë, rreth orës 20:30-21:00, ushtarëve, që gjendeshin në këtë segment të kolonës, iu bashkuan edhe policët dhe paramilitarët. Ata shkuan nga traktori në traktor, duke i sharë dhe kërcënuar refugjatët. Në të njëjtën kohë, kolonës iu afruan edhe ushtarët tjerë që po vinin nga Sllakovci e Cecelia. Ata kishin uniforma të kaltra dhe të gjelbra. Disa kishin mjekra, kurse disa bartnin maska.²¹

Nga ora 21:00, kolona erdhi deri te një kryqëzim rrugësh. Njëra rrugë çonte për në Vushtri, kurse tjetra për në Studime të Poshtme. Forcat serbe e rreshtuan kolonën në drejtim të Vushtrrisë. Ndërkohë, 50 metra larg kolonës filluan të binin granatat, prandaj kolona u nda. Pjesa kryesore e kolonës mbeti në rajonin e Studimes së Poshtme, kurse një pjesë e vogël, prej rreth 1 000 personave u orientua nga forcat serbe në drejtim të Vushtrrisë. Kjo pjesë e kolonës rreth orës 22:00 arriti deri te shitorja bujqësore në Vushtri.²² Kolona u rrethua nga forca të përziera serbe, të cilët erdhën nga pjesa veriore me automjete të blinduara ngjyrë të gjelbër dhe me pizgauerë të mbuluar me gjethe.²³ Rreth orës 23:30 ishte urdhëruar kolona që të vazhdonte rrugën nga Vushtria dhe në mesnatën e 3 majit kishte arritur në qytetin e Vushtrrisë. Shumë kufoma përgjatë rrugës që shpinte për në qytet, ishin parë nga refugjatët.²⁴ Ndërkohë, në Studime gjatë natës, më 2 maj, përkatësisht nga ora 22:00 deri në ora 24:00, ndodhi një masakër e rëndë dhe e tmerrshme, që bënte forcat e armatosura serbe ndaj popullatës civile shqiptare, me ç’rast vranë 99 shqiptarë civilë*, tërësisht të pafajshëm.

¹⁹ *Po aty*, f. 492-496.

²⁰ *Po aty*, f. 492.

²¹ *Po aty*.

²² *MSKG*, predmet Đorđević Vlastimir..., f. 443.

²³ *Po aty*, f. 443-444.

²⁴ *Po Naređenju – Ratni zločini na Kosovu...*, f. 497.

* Namon Gërguri, Enver Gërguri, Adnan Bunjaku, Ramush Gërguri, Agim Gërxhaliu, Fatmir Gërxhaliu, Zenë Gërxhaliu, Kadri Gërxhaliu, Sejdi Gërxhaliu, Fahri Gërxhaliu, Shaban Gërxhaliu, Nuhi Gërxhaliu, Haki Gërxhaliu, Xhevdet Gërxhaliu, Avdyl Gërxhaliu, Skender Gërxhaliu, Imer Gërxhaliu, Hajrullah Gërxhaliu, Nexhip Gërxhaliu, Bajram Gërxhaliu, Qazim Hyseni, Hysen Hyseni, Xhevdet Hyseni, Enver Prronaj, Zymber Prronaj, Musli Gërguri, Naip Rashica, Hasan Rashica, Behar Rashica, Muhamet Rashica, Murat Rashica, Eshref Rashica, Fatmir Rashica, Ali Rashica, Deli Rashica, Sherif Sfarça, Skender Sfarça, Ramadan Haziri, Hazir Muli, Asllan Muli, Bislim Ferizi, Mihrije Ferizi, Ruzhdi Ferizi, Ilaz Maksuti, Mehdi Musliu, Ragip Musliu, Bahri Hiseni, Ali Hiseni, Rexhep Konjuhi, Afrim Konjuhi, Xhavit Musliu, Rifat Ferati, Ismajl Popova, Kadrush

Nga fshati Studime ishin 39 veta. Shumica janë ekzekutuar nga afër me gjakftohtësi të plotë dhe me një plumb në kokë. Gjatë kohës së kryerjes së masakrës, ishin plaçkitur mijëra marka (monedhë e atëhershme gjermane) dhe sasi e konsiderueshme e arit. Ekzekutimi është kryer në forma të ndryshme, si: me një plumb në kokë, me bajoneta, me automatik e forma tjera.²⁵

Dëshmitarët që kanë shpëtuar nga kjo natë e tmerrshme, rrëfejnë se gjatë komunikimit të ushtarëve dhe policëve serbë, janë dëgjuar duke u përmendur emrat e këtyre policëve: Aca Kompiroviq (Bukosh), Vojko Periq (Miraqë), Vuçina Janiçijeviq (Sllatinë - ish-komandant i stacionit policor në Vushtrri, 1990-1999), Ilija Elezoviq (Vilanc), Lubisha Simiq (Sllakoc), Zoran Vukotiq, Dushko Janiq (inspektor i MUP-it), Sllobodan Danqetoviq, Dragan Mihajloviq, Nikolla Dimiq (*punëtor në fabrikën e Lllamarinës në Vushtrri, më pas punëtor në Kuvendin Komunal në Vushtrri*), etj. Konfirmimin e pjesëmarrjes së policëve lokalë serbë në masakrën e 2 majit në Studime, e kishte bërë edhe KMLDNJ në Vushtrri.²⁶

Planit forcave të armatosura serbe për vrasjen shqiptarëve iu bashkuan edhe serbët vendorë të cilët ishin angazhuar në strukturat e armatosura të forcave serbe. Kështu atë natë, të datës 2 maj 1999, rreth orës 23:15, të prirë nga polici Srgjan Trifunoviq, futen dhunshëm në shtëpi të vëllezërve Nebih e Bedri Uka. Pas identifikimit, ata i marrin me vete dhe në afërsi të shtëpisë i pushkatojnë që të dy, për t'i ekzekutuar më pas edhe Halim Gërxhaliun dhe Bahri Maxhunin. Kurse në Smrekonicë serbët e Banjskës, Branko Miletiq, Svetislav Rakiqeviq, Pera Danqetoviq (me të birin, të dy punëtorë në “Trans-Kosova”) etj., vrasin Rexhep Maliqin dhe foshnjën njëvjeçare, Kushtrim Mustafa. Në Smrekonicë, po nga të njëjtit serbë të Bajskës, vritet Shefqet Maxhunaj dhe plagoset rënd Idriz Maxhunaj. Të dhënat e plota mbi viktimat e vrasjes në masë që u krye në Studime gjenden në Ditarin Batalioni IV “Rexhep Musa”,²⁷ të Brigadës 141 “Mehë

Musa, Xhavit Mulaku, Ekrem Mulaku, Hisen Bunjaku, Musa Abazi, Remzi Morina, Bajram Muliçi, Sabri Maxhunaj, Sahit Tiku, Driton Maxhuni, Rrahman Ademi, Hamdi Shala, Miran Xhafa, Nazif Xhafa, Nezi Beqiri, Shaban Krasniqi, Istref Ferati, Feride Sylja, Salih Muzaqi, Bejt Kolla, Tafil Ibishi, Islam Musa, Agim Hiseni, Driton Xhafa, Beqir Hiseni, Agim Sadiku, Ali Mernica, Naser Zhegrova, Bahri Haxhaj, Bajram Kurti, Hisni Bunjaku, Qamile Fejzullahu, Salih Muzaqi, Shehide Sfarça, Ramadan Aliu, Milazim Ferati, Ramiz Baku, Fetah Tahiri, Besim Muzaqi, Fehmi Tërnavë, Brahim Mehmeti, Faik Vidishiçi, Murat Peci, Azemine Vërshevc, Remzi Aliu dhe Gani Muli.

²⁵ Izet Miftari, *Masakra e Studimes, Fjalori Enciklopedike i Kosovës, II, L-ZH, Prishtinë: “Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës”, 2018, f. 1060; S. Sylja, Shala e Bajgorës në luftën çlirimtare...*, f. 2291-294.

²⁶ S. Hasani, *Qyteti Tragjik...*, f. 111.

²⁷ *Ditari i Batalionit IV “Rexhep Musa”.*

Uka” të Zonës Operative të Shalës. Musë Tërbunja, njëri nga ish-komandantët lokalë të UÇK-së, përgjegjës për sektorin Studime e Epërme-Studime e Poshtme, në një intervistë dhënë organizatës Human Rights Watch (HRW) më 18 gusht 1999, deklaroi se ushtarët e tij kishin varrosur trupat e viktimave dhe që të gjithë ishin nga kolona. Ai kishte deklaruar: “...ishin 92 kufoma, që të gjithë nga kolona. Midis tyre kryesisht kishin qenë shoferët e traktorëve me rimorkio. Kishte shumë traktorë të braktisur, e në to kishte edhe njerëz të vrarë. Shumica ishin vrarë nga afërsia, përveç 2-3 vetëve. Mendoj se shumica ishin goditur në kokë dhe pjesë të epërme të trupit. Gjetëm shumë gëzhoja nga armët automatike të prodhuara në Jugosllavi, kishte edhe gëzhoja nga pistoletat”.²⁸ Të njëjtat u pohuan edhe nga ata që kishin ndihmuar varrosjen e viktimave në fjalë: “... të gjitha kufomat ishin të masakruara, pa kokë, duar apo këmbë. Vetëm dy kufoma nuk qenë masakruar. I mbuluam kufomat, hapëm disa varre dhe në secilin varr vendosëm nga pesë kufoma. I varrosëm me ndihmën e disa ushtarëve të UÇK-së. Nuk mundëm t’i varrosnim të gjithë më 3 maj, por vetëm 34 kufoma”.²⁹ Kjo masakër ishte fotografuar dhe fotot janë dorëzuar në Gjykatën e Hagës si dëshmi për krimet e bëra serbe.³⁰ Akuza e Tribunalit të Hagës, thekson se forcat serbe në natën midis 2-3 majit 1999, kishin vrarë 105 persona, të cilët në kolonë po lëviznin nga Studime në drejtim të Vushtrrisë.³¹

Në grumbullin e njerëzve kishte edhe të plagosur. Gjatë mesnatës së 2-3 majit të plagosurit fshiheshin nga familjarët dhe turma e njerëzve që mos të hetohen nga serbët. Diku rreth orës 07:30 një grup policësh të prirë nga Dragan Petroviq (komandant i Policisë në Vushtrri), i ndajnë burrat nga gratë.³² I renditin në kolonë, të gjuhëzuar dhe duart pas qafe, duke identifikuar një nga një me letërnjoftim në duar. Ata që nuk ishin të komunës së Vushtrrisë rreheshin brutalisht dhe veçoheshin nga të tjerët me arsyetimin se “ju vini nga vendluftimet”. E aty kishte shumë prej vendeve të ndryshme: të Mitrovicës, Podujevës, Kastriotit (Obiliqit), Skënderajt Drenasit, etj., të ikur nga vendbanimet e tyre. Përreth dy orë ata qëndruan të

²⁸ *Po Naređenju - Ratni zločini na Kosovu...*, f. 498.

²⁹ *Po aty*, f. 497-498.

³⁰ *Po aty*, f. 498; Batalioni IV “Rexhep Musa”, *Procesverbal mbi dorëzimin e materialit arkivor nga incizimi i masakrës së Studimes*, përfaqësuesve zyrtarë të Tribunalit të Hagës, më 9 korrik 1999.

³¹ *MSKG*, predmet Đorđević Vlastimir..., f. 446.

³² Joanne Mariner, *Krimet e luftës në Kosovë*, Human Rights Watch, përktheu nga origjinali anglisht: Mustafa NANO, Virgjil MUÇI, f. 149. Raporte të përmbledhura nga të mbijetuarit e kësaj ngjarje pas përjetimeve të tmerrshme pasi kishin kaluar në burgu famëkeq i Smrekonicës për në Shqipëri.

gjunjësuar me duar pas qafe duke u bërë verifikimi i meshkujve. Pastaj drejtuesit e automjeteve i liruan për t'u bashkuar familjarëve (rreth 200 shoferë të traktorëve).

Fushata e dhunës kundër civilëve shqiptarë kishte përmasa të mëdha e shtrirë në të gjitha aspektet e saj. Më 5 maj 1999 grupe të armatosura serbe plaçkitnin e më pas digjin shtëpitë e qytetit në Vushtrri. Ata hynë edhe në shtëpinë e Hamdi Fazliut, në të cilën ishin strehuar shumë njerëz. Gratë i vendosin në njërën nga dhomat, ku i keqtrajtojnë në mënyrën më çnjerëzore. Burrave që i vendosën në dhomën tjetër të shtëpisë u kërkuan mjete financiare, kinse për t'i shpëtuar nga vrasja. Pasi u marrin të gjitha të hollat që i patën dhe të mirat materiale që ishin në shtëpi, në fund i vrasin katër prej tyre.* Ndërkohë, më datë 10 maj 1999 aeroplanët e NATO-s bombarduan fabrikën e municionit në Skënderaj në vendin ku ishin forcat e mëdha serbe të vendosura në të. Serbët nga ato sulme pësuan humbje të madhe dhe kështu, si çdo herë siç hakmerrej Serbia kundër civilëve shqiptarë, i rrethon civilët në fshatin Klinë dhe shumë prej tyre vriten.

Në mesin e tyre kishte banore edhe nga Vushtrria, si: Afije, Bukurije e Xhevahire Beqiri etj. Serbët i marrin kufomat e të vranëve dhe i vendosin në vendin ku i kishte bombarduar NATO. Dhe nuk hezitojnë t'i paraqesin si viktima të bombave të NATO-s. Por kjo hedh poshtë këtë mendim, ngaqë rezultatet e ADN-së dhe verifikimi i mjekëve ligjorë të EULEX-it vërteton mënyrën reale të vrasjes.³³ Kishin shenja torture në trup dhe ekzekutimi i tyre kish ardhur nga plumba të shumtë të trupit. Xhevahirja kishte plumba në kurriz, qafës dhe në ije kishte tre plumba që tregon mënyrën e egër të ekzekutimit të tyre nga forcat serbe.³⁴ Më datë 13 maj 1999, në hyrje të fshatit Studime, forcat ushtarake serbe që ishin të pozicionuara te magazinat "Çyqavica" afër lagjes "Gërxhaliu" në Studime të Poshtme, i rrethuan disa civilë shqiptarë, të cilët pasi dorëzohen u masakruan në mënyrë mizore tek vendi i quajtur "Hambari i Gumnishtës".* Një ditë më pas, më 14 maj 1999,

* Hamdi Fazliu, Avdullah Fazliu, Fatmir Fazliu dhe Enver Rustolli, që të gjithë nga Vushtrria.

³³ Departamenti i Drejtësisë Zyra e Ekzaminues Mjekësore, Nr. Referent. ICTY, QR03/001B, Autopsia, shkaqet e vdekjes së Xhevahire Bejtush Beqirit janë verifikuar më 31. 08. 2000. Nga Instituti Mjekoligjor Patologjik, MD. PhD. "Terttu Sarkioja", me ekipin mjekësor nga dr. Marek Gasior M.D, dr. sc. Forencis Medical Doctor. Më 24. 03. 2009. Është regjistruar në librin e amzës së të vranëve OMPFR 3 EULEX, dhe në QR03/001B.

³⁴ Gunshot injury in the neck and pelvis. (plagë të shkaktuara nga armëzjarri në qafë dhe legen - ije), shkruan në raportin mjekoligjor të datës; 25. 08.2000. QR 03/001B.

* Hamdi Krasniqin - Zhilivodë (Trimor), Milaim Muhaxherin - Lum i Madh, Ramadan Zenelin - Tërllabuq, Bedri Beqirin - Sllakocv /Grykë, Besim Muhaxherin - Lum i Madh dhe Jetullah Mulliqin - Sllakocv /Grykë.

forcat e kombinura serbe (ushtarë, policë e paramilitarë) u futën në shtëpitë e boshatisura të shqiptarëve në fshatin Studime e Poshtme dhe nga aty sulmuan me armë kalimtarët e rastit. Si pasojë e këtyre sulmeve u vranë 6 persona.³⁵

Më datë 20 maj 1999, forcat serbe të udhëhequra nga Boban Janiqeviq (komandanti i stacionit policor në Prelluzhë), Zoran Kostiqi, Boban Vojnoviq (Bibi), Trajko Rakiq etj., së bashku paramilitarët çerkezë, Isak Cej, Haki Cej dhe Mustafë Cej, që të tre bashkëpunëtorë të policisë serbe (të mobilizuar si policë lokale serbë), e grumbulluan popullatën civile shqiptare të Stanofcit të Ulët dhe Lumit të Madh dhe duke i maltretuar i larguan nga shtëpitë e tyre. Në këtë grumbull, disa serbë nga Prelluzha ngulfatën dy fëmijë (foshnjë) të familjes Vojvoda nga Stanofci i Vushtrisë: Agron Ismail Vojvoda dhe Besarta Avni Vojvoda (njëvjeçare), duke ua këputur atyre kokat pasi i rrëmbyen nga duart e nënave të tyre.³⁶

Masakra e 22 majit në Vushtrri

Në mëngjesin e 22 majit të vitit 1999 forcat e armatosura serbe organizuan një operacion në qytetin e Vushtrisë. Pjesëtarët e UJ-së dhe të njësisve speciale policore të MPB-së të Serbisë (Njësitë për Operacione Speciale) kishin vendosur kontrollin mbi pjesën lindore të qytetit, kurse pjesëtarët e policisë dhe të formacioneve paraushtarake kishin vendosur kontrollin mbi pjesën perëndimore të qytetit. Këta të fundit kishin dëbuar qytetarët nga shtëpitë e tyre, duke i detyruar ata të lëviznin në drejtim të varrezave të qytetit, të rrethuara paraprakisht nga këto forca. Përgjatë rrugës për varreza disa njerëz ishin ndarë nga familjarët e tyre dhe ishin rreshtuar para një muri. Disa nga këta njerëz ishin ekzekutuar me armë zjarrit.³⁷ Nga të dëbuarit, një grup shqiptarësh prej 68 vetash, ishin detyruar nga forcat serbe të ndaleshin në shtëpinë e Kahriman Pasomës, të cilët u plaçkitën fillimisht nga paratë dhe gjerat me vlerë. Ndërkohë, qytetarët që dhunshëm ishin grumbulluar “Tek varrezat” ishin ndarë nga forcat serbe në tre grupe: 1. gratë me fëmijë deri në moshën 15 vjet; 2. të moshës së re dhe mesatare; dhe 3. të moshuarit. Disa nga të grumbulluarit, rreth 1 000 veta, u dërguan në qendrën sportive në Vushtrri, ku u torturuan në forma të ndryshme. Më pas, nga grupi në fjalë disa u dërguan në burgun e Smrekovnicës (fshat në

³⁵ Jetullah Muliqi-Sllakovc, Bedri Beqiri-Sllakovc, Ramadan Zeneli-Vushtrri, Hamdi Krasniqi-Zhilivodë, Milaim Muhaxheri-Stanoc i Poshtëm dhe Besim Muhaxheri-Stanoc i Poshtëm. *Shih: S. Syla, Shala e Bajgorës në luftën çlirimtare...*, f. 298.

³⁶ Intervistë dhënë autorit (Safet Hasani) nga Ismail Vojvoda, babait të Agronit (foshnjës njëvjeçare), më 05.07.2012.

³⁷ *MSKG*, predmet Đorđević Vlastimir..., f. 452-453.

veri të Vushtrrisë), kurse disa të tjerë u dëbuan për në Shqipëri. Nga gjithë kjo krahurë e dhimbshme, më së rëndi dhe më së keqi kanë pësuar 68 shqiptarët që kishin mbetur në shtëpinë e K. Pasomës.³⁸ Pengmarrësit shqiptarë janë torturuar në forma çnjerëzore, pastaj janë ekzekutuar të gjithë, shumica me një plumb në kokë ose në ballë. Në mesin e të ekzekutuarve kishte femra dhe fëmijë të moshës 15-vjeçare, si dhe të moshuar.³⁹

Pas ekzekutimit, kufomat janë bartur me një kamion dhe janë dërguar në Serbi, përkatësisht në varrezat masive në qendrën e Njësisë Antiterroriste në Batanjiçë, Beograd. Tre personat përgjegjës, nën komandën e të cilëve gjendeshin forcat serbe, ishin: Vuqina Janiqijeviq, Dragan Petroviq dhe Lubisha Simiq, zv/komandant policie në Vushtrri.⁴⁰ Dëshmitarët që kanë shkuar në shtëpinë ku është kryer krimi, kuptohet pasi janë larguar forcat pushtuese serbe dhe kufomat e të ekzekutuarve shqiptarë, tregojnë se kishte shumë gjurmë të gjakut nëpër mure, në dysheme dhe vende të tjera të shtëpisë. Pas luftës së vitit 1999, përkatësisht deri më 2015, janë kthyer kufomat e 67 shqiptarëve të vrarë më 22 maj 1999 dhe ka mbetur edhe 1 (një), Bukurie Shkreli, që nuk iu kanë gjetur eshtrat.

Masakra e 24 majit 1999 - vrasja e tetë vajzave shqiptare

Në qytetin e Vushtrrisë dhe rrethinë, ashtu si në pjesë tjera të Kosovës, krahas vrasjeve e masakrave, dëbimeve, djegieve, rrënimëve, plaçkitjeve, kidnapimeve, burgosjeve etj., ndër format më të rënda të krimit ishte dhunimi seksual i femrës shqiptare. Sipas një dokumenti të kohës, më 14 prill 1999, policia serbe me dhunë kishte marrë vajzën 16-vjeçare, Vasfie Krasniqin, duke i shkaktuar kështu edhe trauma psikike.⁴¹ Ky akt i forcave

³⁸ *Fjalori Enciklopedik i Kosovës II (L-ZH)...*, f. 1062.

³⁹ Ali Melenica, Hasan Melenica, Shaban Melenica, Nistret Melenica, Shefki Melenica, Ibrahim Zeqiri, Driton Murseli, Rafet Behrami, Burim Behrami, Kemajl Tërnavë, Isak Maçastena, Fehmi Musa, Arsim Musa, Xhafer Shaqiri, Rrahim Shatrolli, Muharrem Bajrami, Lulzim Bajrami, Naim Bajrami, Afrim Bajrami, Hamit Halili, Hilmi Halili, Hamdi Dallku, Agim Dallku, Bashkim Dallku, Jeton Vërbovci, Arsim Sejdiu, Zeqir Kadriu, Ferki Kadriu, Haki Kadriu, Shahin Feka, Ekrem Feka, Miradie Feka, Bedri Kutllavci, Bujar Krasniqi, Faik Mulaku, Driton Merovci, Mensur Gërguri, Brahim Maloku, Arian Prokupla, Shahidin Maxhuni, Murat Tiriqi, Serhat Tiriqi, Ahmet Uka, Sekine Uka, Ajshe Uka, Rrahim Shkreli, Bukurie Shkreli, Fatmir Keqolli, Fazli Shabani, Idriz Hasani, Ramadan Shaqiri, Hajdin Shaqiri, Besnik Shaqiri, Naser Zeka, Nexhmedin Zeka, Agim Zeka, Bajram Meha, Ramadan Meha, Avdi Bardiqi, Rrahman Ferati, Zeqir Zeqiri, Irfan Zhilivoda, Muhamet Kadriu, Muzafer Muhaxheri, Agim Shaqiri, Bajram Islami, Ibrahim Islami dhe Bahri Sylla. *Shih: S. Sylla, Shala e Bajgorës në luftën çlirimtare...*, f. 295-298.

⁴⁰ *MSKG*, predmet Đorđević Vlastimir..., f. 452-453.

⁴¹ *Batalioni IV "Rexhep Musa"*, Njoftim nga komandanti i Kompanisë së Parë - Osman

serbe kundër femrës shqiptare, ka pasur karakter hakmarrës e politik të thyerjes morale, andaj kjo dukuri që ndër format më të dhembshme e më të rënda të krimeve të luftës në Kosovë.

Më 24 maj 1999, rreth orës 15:00, një grup vajzash (8 veta), derisa po kalonin lumin Studime, u vranë dhe u masakruan barbarisht nga forcat pushtuese serbe.⁴² Ekzistojnë dyshime të bazuara se ekzekutimi i viktimave në fjalë është shoqëruar paraprakisht me aktet e dhunimit. Ish-komandanti i Batalionit, Gani Imeri, intervistuar nga HRW, më 16 gusht 1999, kishte deklaruar se “*më 24 maj 1999, në afërsi të lumit të cekur më lart, kishte gjetur rreth tetë trupa femrash. Dy prej tyre kishin pasur plagë nga thika në pjesën e gojës, kurse disa kishin pasur edhe rrobat e shqyera, gjë që mund të çojë deri tek konkluzioni se disa prej tyre ishin dhunuar*”.⁴³ Edhe ish-komandanti i UÇK-së në Studime, Musë Terbunja, intervistuar po ashtu nga HRW, më 18 gusht 1999, kishte deklaruar se “*ushtarët e tij rreth mesnatës së 23 majit kishin gjetur kufomat e tetë femrave, gjashtë prej të cilave kishin qenë tek përroi i lumit, kurse dy tjera më larg. Edhe ky beson se ato ishin dhunuar pasi që rrobat i kishin pasur të shqyera*”.⁴⁴ Tërheqjen e kufomave, identifikimin dhe varrimin e tyre në fshatin Studime e Epërme, e bënë ushtarët e Batalionit IV, gjegjësisht Kompania II.⁴⁵

Ekspertja e Human Rights Watch, Martina Vandenberg, në raportin prej 37 faqesh të HRW-së, të publikuar më 21 mars 2000, ku përshkruhen rastet e dhunimeve seksuale të femrave në Kosovë, ndër to edhe në qytetin e Vushtrrisë, në bazë të dëshmive të shumta konstaton se: “*forcat e armatosura të Jugosllavisë dhe të Serbisë janë përgjegjëse direkt për dhunimin sistematik të grave dhe të vajzave shqiptare në Kosovë gjatë sulmeve ajrore të NATO-s*”.⁴⁶ Në shumicën dërmuese të rasteve, viktimat,

Musliu për Komandën e Batalionit, 14.04.1999.

⁴² Lutfie Gërguri, Shemsie Gërguri, Hysnie Gërguri, Imrane Gërguri dhe Zejnepe Gërguri nga fshati Studime e Epërme. Ndërsa, Lumnije e Nazmije Krasniqi nga Zhilivoda dhe Remzie Jashari nga Pasoma. *Shih: Ditari i Batalionit IV “Rexhep Musa”*.

⁴³ Frances T. Pilch, “Sexual Violence and the Crisis in Kosovo”, *Refugee*, Vol. 18. No. 3 (August 1999), f. 30.

⁴⁴ *Po Naredënja - Ratni zločini na Kosovu...*, f. 502.

⁴⁵ Intervistë dhënë autorit (Sabit Sylja) nga Gani Imeri ish-komandant i Batalionit IV të Brigadës 141 të Zonës Operative të Shalës, qershor 2018.

⁴⁶ Raport i KMDLNJ-së, Dëshmi të hidhura: Masakrimi i familjeve - skenar i zhbërjes së genies shqiptare, punim i cituar; Luljeta Selimi, Rrëfime tronditëse - femrat e dhunuara gjatë luftës..., vep. e cit. / KMDLNJ, Dëshmi të hidhura: Masakrimi i familjeve - skenar i zhbërjes së genies shqiptare, pun. i cit.; Luljeta Selimi, Rrëfime tronditëse - femrat e dhunuara gjatë luftës së Kosovës, vep. e cit. / KMDLNJ, Dhunimi plagë që vështirë shërohet, pun. i cit. / Luljeta Selimi, Dosja e dhunimit: “Vajzat e reja, pas aktit barbar i çonin në Serbi”, botuar te pashtriku.org, më 23 dhjetor 2007./ Luljeta Selimi, Rrëfime

para se të ekzekutoheshin, ishin objekt i shfrimit shtazarak, i rrahjeve, i torturave nga më të egrat, i dhunimit seksual, i fyerjeve dhe i poshtërimit moral e pastaj edhe i ekzekutimit e masakrimit në format më barbare.⁴⁷ Përveç femrave të dhunuara dhe atyre të vrara ekziston edhe një numër i madh i atyre që konsiderohen të zhdukura.⁴⁸

Masakra në familjen e Selatin Gerxhaliut, 31 maj 1999

Në orën 04:00 të mëngjesit, të datës 31 maj 1999, shqiptarët e fshatit Studime e Poshtme u shqetësuan nga dy detonime të fuqishme. Së shpejti u kuptua se dy avionë të NATO-s kishin bombarduar kazermën e vjetër në Vushtrri. Nuk kaloi shumë kohë kur artileria dhe minahedhësit e Brigadës 37 të Motorizuar filluan sulmin kundër banorëve të fshatit Studime e Poshtme. Brenda një ore policët e njësisve speciale të ndarë në grupe nga 2-3 policë, u futën nëpër shtëpitë e shqiptarëve. Ata i tmerruan banorët, ua plaçkitën gjërat me vlerë dhe i dëbuan nga shtëpitë e tyre dhe nga fshati. Me këtë rast, njësitet speciale policore dhe ato të policisë së rregullt serbe vranë dhjetëra shqiptarë, përfshirë edhe 12 anëtarët e familjes Gerxhaliu.⁴⁹ Edhe më 28 mars 1999, një polic serb, kishte vrarë Shahin Gerxhaliun, djalin e Selatinit. Kështu, nga familja Selatini u vranë 13 anëtarë të një shtëpie.

Sipas dëshmitarëve, në fillim policët serbë kishin zënë peng Xhemajlin, Selatinin dhe Shabanin (djalin e Selatinit) dhe i kanë detyruar të qëndronin në dhomën ku është kryer krimi makabër ndaj familjes së Selatin Gerxhaliut, me qëllim që të shohin se si i ekzekutonin familjarët e tyre! Pasi i kanë ekzekutuar familjarët e tyre, të tre të zënit peng (Selatinin, Shabanin dhe Xhamajlin), i kanë larguar rreth 500 metra nga shtëpia ku ishte kryer krimi, te vendi i quajtur “Hambari i Gumnishtës” dhe aty i ekzekutuan. Pas aktit të kryer, pjesëtarët e UÇK-së gjetën trupat e tre burrave nga kjo familje që ishin vrarë, jo larg shtëpisë së tyre.⁵⁰ Ndërsa, nëntë anëtarët e tjerë të

tronditëse - femrat e dhunuara gjatë luftës..., vep. e cit. / Intervistë e Riza Lahit me Luljeta Selimin: “Unë Dragan Spasiq jam njeriu që me dorën time kam prerë fytin e 50 shqiptarëve!”, gusht

2004.http://www.beepworld.de/members/pashtriku/krimet_kosove_9899.htm.

⁴⁷ *KMDLNJ* - doc. nr. 048/99

⁴⁸ S. Hasani, *Qyteti Tragjik...*, f. 137.

⁴⁹ Sala Gerxhaliu, Xhemajl Gerxhaliu, Selatin Gerxhaliu, Fexhrije Gerxhaliu, Sofije Gerxhaliu, Shaban Gerxhaliu, Muharrem Gerxhaliu, Mexhid Gerxhaliu, Avdurrahman Gerxhaliu, Safer Gerxhaliu dhe Sabahudin Gerxhaliu (5-vjeçar). Shih: Dosije Diković Ljubiše, *Fond za humanitarno pravo*, Beograd, 23 janar 2012, <http://www.hlc-rdc.org/wp-content/uploads/2012/10/Ljubisa-Dikovic-Dosije-and-Prilog.pdf>, f. 12.

⁵⁰ *Dëshmorët e Ushtrisë çlirimtare të Kosovës*, Grup autorësh, Libri i tretë, Prishtinë, 2003, f. 229.

familjes, midis së cilëve edhe gjashtë fëmijë të moshës nën 14 vjeç, ishin vrarë brenda shtëpisë së tyre.⁵¹ Ka dëshmi që menjëherë pas krimit në afërsi ishin parë shtatë policë serbë. Pas një kohe trupat e pajetë, në mesin e të cilëve kishte edhe fëmijë, ishin gjetur në shtëpinë e Selatin Gerxhaliut.⁵² Kjo masakër ishte fotografuar dhe fotot janë dorëzuar në gjyqin e Hagës si dëshmi për krimet e bëra serbe.

⁵¹ *Po Naređenju – Ratni zločini na Kosovu...*, f. 502-503

⁵² *MSKG, predmet Đorđević Vlastimir...*, f. 553.